



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2327/11 Prot.

Tiranë, më 29.12.2025

VENDIM

Nr. 05, datë 29.12.2025

PËR

MIRATIMIN E LISTËS PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE (BACHELOR), PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, në Urdhrin e Administratorit të Universitetit të Arteve nr. 132, datë 24.10.2025, "Për fillimin e procedurës së pranimit të aplikimeve, nga ana e fakulteteve të UART, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve", bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga çdo student aplikues, shkresat me listat e studentëve aplikantë të përgatitura nga Kryetaret e Degëve dhe Sekretarët Mësimorë të secilit fakultet, pas verifikimeve dhe shqyrtimit e diskutimit nga Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentëve aplikues renditur në *Shtojcën nr. 1* bashkëlidhur këtij vendimi që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve Bachelor pranë të Fakultetit të Muzikës, Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).



3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Fakulteti i Artit Skenik pranë Universitetit të Arteve si dhe Drejtoria Ekonomike.

4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik Bisha

(Kryetar)

Etjola Kola

(Anëtar)

Oltjon Muzaka

(Anëtar)

Anisa Pollo

(Anëtar)

Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi

(Anëtar)

Lorenc Vangjeli

(Anëtar)

Vladimir Llakaj

(Anëtar)